

Fillon punë Qendra Këshilluese psiko-sociale

Kontribuar nga Manager

Monday, 15 February 2010

Azhornuar fundi Tuesday, 23 March 2010

Në një ceremoni rasti, në ambientet e Shkollës Fillore "Ahmet Delia" në Skenderaj, në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues të Qendrës për Përparim, Edukim dhe Arsim nga Ferizaj, inspektorë rajonal të arsimit, zyrtarë komunalë të Skenderajt dhe të ftuar tjerë, ka nisur punën Qendra Këshilluese për fëmijë, të rinj dhe prindër për fëmijët me pengesa specifike në mësim dhe me probleme tjera, të cilat kërkojnë trajtim profesional dhe të organizuar.

Kjo qendër profesionale i ndihmon fëmijët, prindërit dhe mësimdhënësit të zgjidhin probleme të natyrave të ndryshme, psikosociale, psikiatrike, edukative, zhvillimore, etj, si dhe ofron shërbime diagnostike, këshilluese, korrektuese e terapeutike për fëmijë, prindër dhe të rinj. Projekti implementohet nga Qendra për Përparim, Edukim dhe Arsim nga Ferizaj, në përkrahje financiare nga "Trauma Foundation (Fondacioni i traumës së luftës)" nga Holanda, ndërsa mbështetet nga DKA në Skenderaj dhe MASHT-i. Sipas organizatorëve, në këtë projekt janë përfshi 10 shkolla fillore të Skenderajt, të cilat do të zhvillojnë seminare për të aftësuar mësimdhënësit që punojnë me nxënës.